

Kështu praktikoni ju me fëmijën tuaj për shkollën në gjermanisht dhe në gjuhën shqipe :

Përgatitja:

- Gjeneroni një vend sa më të qetë me fëmijën tuaj.
- Ambjenti i qetë është i rëndësishëm për të mësuar.
- Pajisjet shkollore vendosini mbi tryezë (mbi tavolinën e punës) .
- Fëmija juaj ju tregon juve detyrat.
- A ka ndonjë fletore informacioni shkollor? Ju kontrollojeni atë çdo ditë .

Më së fundi shikoni:

- A është çanta e shkollës e rregullt, e sistemuar?
- A janë të gjitha materialet e nevojshme aty?
- Ju duhet të kënaqëni me fëmijën tuaj, sa mirë e sa bukur mëson ai/ajo.
- **Lavdërojeni ju herë pas here atë!**
- Kontrolloni ju rregullisht së bashku me fëmijën tuaj tek faqja informative e shkollës në internet (Homepage) .

Mos harroni:

- **Të mësuarit ka nevojë për ambient/dhomë të qetë dhe kohë.**
- **Të mësuarit ka nevojë për sukses e motivim. Ju duhet të mbështetni fëmijën tuaj për këtë!**
- **Të mësuarit duhet të jetë tërheqës, e të sjellë kënaqësi.**
- **Fëmija i juaj çdo ditë duhet të lexojë 10 minuta me zë të lartë.**

Praktikoni, ushtroni ju çdo ditë me fëmijën tuaj për shkollën:

<p>1. Fëmija juaj ka nevojë për një vend sa më të qetë për të punuar. Uluni ju pranë tij/saj.</p>
<p>2. Fëmija juaj flet për ditën se si kaloi në shkollë, Dëgjojeni ju atë me vëmendje.</p>
<p>3. Fëmija, ju shpjegon juve të gjitha detyrat e ditës. Pyeteni ju për ato (tregoni interes).</p>
<p>4. Kur fëmija mëson detyrat e tij në gjermanisht, lexon me zë të lartë dhe ngadalë, të gjitha shkronjat, fjalët dhe fjalitë . Atëherë, ju përkthejeni në gjuhën tuaj së bashku me të.</p>
<p>5. Fëmija juaj, ju tregon detyrat e kryera/të përfunduara. Lavdërojeni ju fëmijën tuaj..</p>
<p>6. Këshilla të dobishme ditore:</p> <ul style="list-style-type: none">- Emërtoni shumë gjëra në gjermanisht dhe në gjuhën shqipe, në jetën e përditshme:<ul style="list-style-type: none">➤ ngjyrat , personat, sendet apo objektet që ju rrethojnë➤ artikujt e produktet e ndryshme ushqimore➤ simbolet e rregullat në qarkullinin rrugor➤ pjesët e trupi,rrobat, veshmbathja etj.- shkruaj një listë gjërash se çfarë blini në pazar- përshkruani fotografitë apo portretet e ndryshme.
<p>Vazhdimisht përpiquni që kudo që të ndodheni së bashku me fëmijën tuaj ai/ajo, të lexoje apo të përsërisi fjalët gjermanisht me zë të lartë.</p>

